



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK DIVJAKË

Nr 8217/116 Prot.

Divjakë më 18 / 11 / 2024

Lënda:

THIRRJE

“PËR ZHVILLIMIN E MBLEDHJES SË RADHËS, TË KËSHILLIT BASHKIAK
DIVJAKË, MUAJI NËNTOR 2024”

ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK

Për dijëni: KRYETARIT TË BASHKISË DIVJAKË
PREFEKTIT TË QARKUT FIER

Në mbështetje të nenit 53 pika 4, neni 56, pika 2, gërma (a) të Ligjit nr 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Divjakë, miratuar me VKB, nr 28 datë 13.04.2020, ndryshuar me V.K.B. Nr.48 datë 25.09.2023, neni 56, Ju njoftojmë se: Më datë: 25.11.2024, ditën e Hënë ora 10:00, në Sallën e Mbledhjeve, pranë Shtëpisë së Kulturës Divjakë, në katin e dytë thirret “Mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Divjakë për muajin Nëntor 2024”. Me këtë

Rend dite:

1. Miratim i Rendit të Ditës.
2. Miratim i Proçesverbalit të mbledhjes që u zhvillua më datë 25.10.2024
3. Informacion mbi zbatimin e Vendimeve të Këshillit Bashkiak Divjakë për muajin Tetor 2024.
4. Projekt-vendim - Për miratimin e familjeve që do të trajtohen nga Fondi i kushtëzuar deri 6% “ për bllok ndihmën “ për muajin Tetor 2024.
5. Projekt-vendim - Për miratimin e “Paketës fiskale për sistemin e taksave e tarifave vendore, dhe penalitete për kundravajtjet administrative për vitin 2025, Bashkia Divjakë”
6. Projekt-vendim - Për miratimin e “Rinovimit të kontratës me nr 4137 datë 13.09.2022” Për transportin e udhëtarëve në linjat urbane për Bashkia Divjakë”.
7. Projekt-vendim - Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Agjensisë shtetërore të kadastrës dhe Bashkisë Divjakë në zbatim të VKM nr. 435 datë 26.06.2024 “ Për një shtesë në VKM nr 867, datë 10.12.2014 “ Për proçedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore.
8. Projekt-vendim Për miratimin e dokumentit “ Strategjia vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe plani i veprimit në teritorin e Bashkisë Divjakë 2024-2030.
9. Projekt-vendim -Mbi miratimin e planit të Aktiviteteve të Këshillit Bashkiak Divjakë për vitin 2025.

-Komisionet përgjegjës sipas pikave në Rendin e ditës janë:

-Për pikat Nr: 4,5,6,7, Komisioni i Ekonomisë dhe i Financave.

-Për pikën Nr.8, Komisioni i Bujqësisë, Pyjeve, Menaxhimit të Ujrave, Mbrojtjes së Mjedisit dhe Emergjencave Civile.

Duke Ju falenderuar!

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

